



**Shoqata e të Verbërve të Kosovës**  
**Kosova Association of the Blind**  
**Udruzenje Slepih Kosova**

# Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

**Nr. 21**

Shkurt, 2024



Funded by  
the European Union

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Këshilli botues:

Enver Ulaj

Melihate Pllana

Bekim Krasniqi

Florian Tishuki

# Përmbajtja

Dy fjalë për botimin.....	faqe
Nga aktivitetet e SHVK gjatë muajve janar dhe shkurt 2024.....	faqe
Historiku i Lous Brail jeta dhe vepra.....	faqe
Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.....	faqe
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, krijimi i kushteve dhe plotësimi i kuotës .....	faqe
Mundësia e regjistrimi dhe funksionimit të Ndërmarrjes Sociale.....	faqe
Nga aktivitetet e QBMK Xheladin Deda, edukimi i personave të verbër.....	faqe
Drejtësia, për kë dhe kujt i duhet? .....	faqe
Qasja për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, qasja fizike në objekte .....	faqe
Lajme sportive- aktivitetet sportive për personat e verbër .....	faqe
Sporti për të verbër ndër vite, shoqata sportive “Shkolla” .....	faqe

## Dy fjalë për botimin

Botimi i numrit të radhës së revistës sonë gjatë muaji shkurt është numri i 21-të i revistës. Më vështirësitë dhe sfidat që ka botimi i saj po përmbyllim edhe një numër me shpresën që lexuesit t'i ofrojmë një material të larmishëm që të lexojë dhe mbajë më gjatë për lexim por edhe për nevojat e veta të informimit. Çështja e informimit të personave të verbër në Kosovë mbetet një problem sfidues për shoqatën dhe për gjithë shoqërinë kosovare. Për këtë arsye revista jonë ka këtë format që ka dhe është e veçantë në ofrimin e materialeve më të qëndrueshme dhe verifikuara që synojnë të sjellin pasqyrë të ngjarjeve dhe rrjedhave që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi dhe personat e verbër në veçanti në Kosovë.

Ky numër përmbledh aktivitetet kryesore që kanë të bëjnë me jetën e personave të verbër, informata nga angazhimet tona si Shoqatë, për përmirësimin e kushteve të jetës dhe ofrimin e shërbimeve për personat e verbër. Janë artikujt e përhershëm mbi edukimin, aktivitetet kulturore dhe sportive, etj. Në tre artikujt kemi qasje personale të identifikuar në probleme specifike si artikulli tematik lidhur me sportin dhe shoqatën sportive Shkolla në Pejë, mbi çështjen e drejtësisë në tranzicion në Shqipëri shkruar nga një nga juristët më të mirë dhe person i verbër si dhe një këndvështrim nga Zyra për Qeverisje të mirë pranë Zyrës së kryeministrit të Kosovës.

Dy nga artikujt më specifikë kanë të bëjnë me dy çështje që shpresojmë të ngjallin interesimin tuaj: si është gjendja e punësimit të personave më aftësi të kufizuara në Kosovë dhe sa e përmbushë këtë kërkesë ligjore shteti i Kosovës dhe e artikulli i dytë në të njëjtën paraqitje lidhur me qasjen e personave më aftësi të kufizuara në raport me institucionet e Kosovës.

Dhe për fund shkrimet kushtuar Lui Brajit në ditë shënimit të ditëve të brajit si dhe një artikull të shkurtër lidhur me ndërmarrjet sociale dhe mundësitë që ka SHVK në këtë ndryshim të legjislacionit tonë në Kosovë.

Shpresojmë që t'ju pëlqejë përmbajtja!

## Nga aktivitetet e SHVK gjatë muajve janar dhe shkurt 2024

### **Pjesëmarrja ne media**

Me 4 janar kryetari i SHVK Daut Tishuki ka marrë pjesë në një intervistë në RTK, në programin Mirëmëngjesi Kosovë, me teme ditët botërore te shkrimit Brail. Gjatë kësaj intervistë z.Tishuki ka theksuar rendësin e shënimit te ditëve te Louis Brail, pasi që literatura ne shkrimin brail është shumë e nevojshme për personat e verbër si mjet fuqizues për pavarësim dhe krijimin e mundësive për të pasur qasje ne informacion si çdo qytetar tjetër.

### **Konference për shënimin e ditëve te Lous Brail**

Me 5 janar është mbajtur konferencë për shënimin e ditëve të brail-it, shpikësit të shkrimit brail, shkrim i vetëm alternativë për personat e verbër. Në këtë konferencë ishin të pranishëm zyrtar të lartë qeveritarë, ambasadori i Republikës së Çekisë, zyrtarë të organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare, përfaqësues të institucioneve shkollore, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe vet personat e verbër. Temë kryesore ishin sfidat që kanë personat e verbër në qasje në literaturë në shkrimin Braille, për krijimin e mundësive të barabarta përmes literaturës së shkrimit braille. Ndërsa në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë, u hap një tendë ku janë prezantuar punimet e personave të verbër dhe materiale të ndryshme të shtypura në shkrimin Braille, mbështetur nga Presidenca e RKS.

### **Donacion nga bashkëvendësi për SHVK**

9 janar 2024- Në zyrën e SHVK-së ishte në takim një mërgimtar z. Shiqeri Bajrami, nga Kamenica, i cili nga të ardhurat familjare ndau për SHVK-në 1000 € dhe 1000 € të tjera për shoqatën ndërkomunale të të verbër në Gjilan. SHVK e falënderuar z. Bajrami për këtë përkrahje, kurse mjetet e dhuruara do të shërbejnë për zbatimin e planit strategjik të SHVK-së.

### **Antologjia e krijuesve të verbër në Kosovë**

Shoqata e të verbërve të Kosovës në kuadër të promovimit të krijimtarisë së personave të verbër dhe në 20 vjetorin e regjistrimit të saj, po boton një antologji të krijimtarisë letrare në poezi dhe prozë te personave të verbër në Kosovë. Libri që do të botohet do të bëhet me përzgjedhjen e krijimeve më të mira letrare të autorëve, që tashmë kanë botuar veprat e tyre në Kosovë. SHVK bën thirrje të gjithëve që kanë botuar libra, ose kanë materiale të botuara nga të tjerët të na ndihmojnë që të krijojmë një publikim gjithëpërfshirës dhe të mos harrojmë asnjë krijues.

### **Takimet mbi funksionimin e ndërmarrjeve sociale**

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka mbajtur në të gjitha qytetet takime informuese. Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka qenë pjesë e sesionit informues në Prishtinë me 24 Janar 2024, ku kemi marrë njohurit e duhura për te aplikuar për krijimin e një ndërmarrje sociale e cila do t’ju shërbej te gjithë personave të verbër por edhe personave tjerë me aftësi të kufizuar.

### **Shoqata e Pejës ka zgjedhur kryetarin e ri**

Shoqata e Pejës ka zgjedhur kryetarin e ri në një kuvend zgjedhor në të cilin kryetar është votuar Xhafer Berisha, i cili zëvendëson ish kryetarin e ndjerë Mehmet Kastrati.

## Historiku i Lous Brail jeta dhe vepra

Louis Braille është shpikësi shkrimi braille. Ai lindi më 4 janar 1809 në Coupvray të Francës. Në moshën 3 vjeçare, teksa luante në dyqanin e babait të tij, Louis plagosi syrin nga një mjet i mprehtë. Pavarësisht kujdesit më të mirë në dispozicion në atë kohë, infeksioni u shfaq dhe shpejt u përhap në syrin tjetër, duke e lënë atë plotësisht të verbër.

Mezi 16 vjeç, Braille, atëherë student në Institutin Kombëtar për Rininë e Verbër në Paris në 1825, kaloi çdo çast jashtë klasës duke hapur vrima në letër, duke u përpjekur të gjente një mënyrë më efikase për të përfaqësuar shkronjat dhe numrat me takt. Deri atëherë, ai dhe shokët e tij studentë të verbër lexonin duke gjurmuar shkronjat e ngritura me gishta. Ishte shumë e ngadaltë dhe pak studentë të verbër e zotëronin teknikën. Shkrimi kërkonte memorizimin e formave të shkronjave dhe më pas një përpjekje për t'i riprodhuar ato në letër, pa qenë në gjendje të shiheshin ose lexoheshin rezultatet.

Louis mori frymëzimin e tij për të përdorur pika të stampuara për të përfaqësuar shkronjat pasi pa Charles Barbier, një oficer artilerie në pension në ushtrinë e Napoleonit, duke demonstruar një sistem të marrjes së shënimeve që ai shpiku me pika të stampuara për të përfaqësuar tingujt (shumica e ushtarëve ishin analfabetë) që do të lejonte shënimet të kalohen në radhët pa i rënë drita, e cila mund të lajmërojë armikun për pozicionin e tyre. Ushtrisë nuk i bëri përshtypje, kështu që Barbier solli sistemin e tij në shkollën për të verbëritë. Louis menjëherë i njohu meritat e tij dhe kaloi tre vitet e ardhshme duke u përmirësuar mbi idenë e Barbier.

Në vitin 1824, Louis kishte kodin që mban emrin e tij dhe përdoret sot pothuajse në çdo vend të botës, i përshtatur pothuajse në çdo gjuhë të njohur. Louis Braille vdiq më 6 janar 1852 në moshën 43-vjeçare, pasi kishte jetuar një jetë të suksesshme si mësues, muzikant, studiues dhe shpikës. Në vitin 2009, bota festoi dyqind vjetorin e shkrimit Braille. Në vitin 1955 UNESCO Shpall Alfabetin Brail universal, për të verbëritë në mbarë botën, teksa Ministria e Arsimit në Shqipëri këtë Alfabet e zyrtarizëm në vitin 1963!

Alfabeti shqip në gjuhën e pikave (në brail) është përgatitur nga Dilaver Zgjani dhe Liri Kamberi bazuar në alfabetin francez të Luis Brailit. Në Shqipëri, sistemi i shkrimit Braj u përpunua në vitin 1963 në një variant që u përshtatet veçorive të gjuhës shqipe dhe po atë vit filluan të shkruhen tekstat e para shqipe me këtë sistem

Ndërsa në Kosovë në bashkëpunim me institutin albanologjikë për të verbër “Ramazan Kabashi” Shoqata e të verbërve të Shqipërisë dhe njohës të shkrimit brail është bërë unifikuar shkrimi brail në gjuhën shqipe ku nga ministri i arsimit të asaj kohe 2019, është marrë vendim për fuqizimin e këtij vendimi.

## Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

Përkundër faktit se Republika e Kosovës nuk është pjesë e Kombeve të Bashkuara për shkak të statusit të saj politik, në kuadër të **nenit 22 të Kushtetutës** shprehimisht thuhet se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, përveç të garantuara me këtë Kushtetutë, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve.

Në rrugëtimin për të qenë një anëtare e familjes së madhe evropiane, Kosova po bënë përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar një shoqëri që respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ndalon diskriminimin. Ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara kërkon qasje dhe politikë aktive dhe pro aktive, të qëllimshme dhe të qëndrueshme, si dhe veprime të përbashkëta të autoriteteve qendrore dhe lokale, institucioneve të pavarura dhe pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile e sidomos të organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara. Pas një përpjekje disa vjeçare të avokimit dhe lobimit të organizatës HANDIKOS, si dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me organizata tjera të personave me aftësi të kufizuar me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë dhe në veçanti Institucioneve vendore, me datë 13 Dhjetor 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të radhës së 112-të, ka marrë Vendimin Nr.02/112 përmes të cilit i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për përfshirjen e Konventës për të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Nenin 22 të Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Me datë 01 Gusht 2023, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke e vendosur si të pranueshme kërkesën e parashtruar nga Kuvendi i Kosovës, ka miratuar përfshirjen e KNDPAK në nenin 22 të Kushtetues së Kosovës, me çka pas miratimit në parlamentin e Kosovës, si pjesë e këtij neni Konventa do të jetë e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë dhe do të ketë epërsi ndaj dispozitave ligjore në Kosovë.

Gjatë vitit 2023 është iniciuar procesi i hartimit të Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2029 poashtu edhe Plani i Veprimit 2024-2026 procese këto të cilat parashihet të finalizohen gjatë viti 2024

(Material i përgatitur për revistën “Syri ynë” nga Zyra e Qeverisjes së Mirë në kuadër të Kryeministrisë së Republikës së Kosovës)

## Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, krijimi i kushteve dhe plotësimi i kuotës

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-019 për Aftësim Riaftësim Profesional dhe për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara janë paraparë punësimi i personave me aftësi të kufizuara në institucione publike dhe private. Ligji parasheh obligimin që një në 50 persona të punësuar të jetë person me aftësi të kufizuara. Se si është gjendje në sektorin shtetëror në Kosovë kemi një raport gjithpërfshorës nga Qeveria e Kosovës. Raporti është përgatitur në kuadër të raportimeve për Kalendarin i aktiviteteve për vitin e aftësisë së kufizuar" që është dokumenti që u hartua në bashkëpunimin e Qeverisë me ministrinë përkatëse dhe me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Fillimisht lidhur me legjislacionin lidhur me punësimin, MFPT ka raportuar për krijimin e UNIREF-it, përkatësisht mundësimin e mbledhjes së të hyrave buxhetore si pagesë mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara.

Sa i përket kuotave për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara më 23.02.2022 Kryeministri i Republikës së Kosovës ka nxjerr vendim i cili obligon organet e administratës shtetërore që të plotësojnë kuotën e punësimit për Persona me aftësi të kufizuara në kuadër të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësim Riaftësim Profesional dhe për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Lidhur me raportimet që kanë ardhur nga institucionet, gjendja është si më poshtë:

Zyra e Kryeministrit në kuadër të obligimit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në kuadër të numrit të përgjithshëm të punësuarve e ka plotësuar kuotën e të punësuarve të personave me aftësi të kufizuara, pasi që aktualisht të punësuar janë 4 persona me aftësi të kufizuara.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve raporton se sa i përket zbatimit të obligimit ligjor të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, i cili përcaktohet në nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në tërë strukturën e sistemit ministror MFPT ka 570 të punësuar, nga të cilët 15 janë persona me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, MFPT është duke e zbatuar obligimin përkitazi me dispozitat e lartcekura.

Ministria e Drejtësisë raporton se brenda strukturës së MD, ka 1880 të punësuar, prej tyre 15 janë persona me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, MD është duke e zbatuar obligimin përkitazi me dispozitat e lartcekura. Ajo që ministria e drejtësisë ka veçuar në raportin e saj është se kriteret për punësim në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si kushte të veçanta për rekrutim për pozitën kadet për zyrtarë korrektues kanë të paraparë që kandidati duhet të jetë i aftë në aspektin psiko-fizike dhe kandidatet të kalojnë testin shëndetësor si dhe testin e shkathësive fizike. Kjo e bën të vështirë në mos të pamundur plotësimin plotë të kuotës një person me aftësi të kufizuara në këtë institucion dhe rrjedhimisht edhe në MD pasi pjesën më të madhe të stafit e përbejnë zyrtarët korrektues.

Ministria e Shëndetësisë ka raportuar se numri i stafit aktual është 130, ndërsa numri i stafit me aftësi të kufizuar është 3, rrjedhimisht MSh-ja është duke e zbatuar obligimin bazuar në dispozitat ligjore.

Sipas strukturës organizative Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe institucionet vartëse të kulturës dhe trashëgimisë kulturore aktualisht i ka gjithsej 540 të punësuar, në mesin e tyre ka të



punësuar katër 4 persona me aftësi të kufizuara, që tregon se MKRS vetëm pjesërisht apo afërsisht 35% e plotëson kuotën e kërkuar me ligj..

Në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është raportuar se nga gjithsej 360 shërbyes civilë ka të punësuar 8 persona me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht është duke e zbatuar obligimin.

Në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit lokal janë gjithsejtë 93 shërbyes civilë dhe në mesin e tyre 2 persona me aftësi të kufizuara, që tregon se kuota sipas ligjit është plotësuar.

Ministria e Zhvillimit Rajonal aktualisht ka të punësuar gjithsej 36 persona dhe në mesin e tyre një person me aftësi të kufizuara, prandaj konsiderohet se është respektuar ligji për kuotën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Në Ministrinë e Mbrojtjes nga numri i përgjithshëm prej 124 nëpunësve civilë, numri i personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe nëpunësit civilë të cilët kanë statusin e invalidit të luftës janë 17 nëpunës të punësuar, ndërsa në Forcën e Sigurisë së Kosovës nga numri i përgjithshëm prej 106 nëpunësve civilë aktualë, numri i personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe nëpunësit civilë, të cilët kanë statusin e invalidit të luftës, janë gjithsej 20 të punësuar. Në kuadër të raportimeve të pranuar konsiderojmë se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, e ka të përmbushur obligimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara i cili përcaktohet në ligj.

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Pjesa e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) janë gjithsejtë 242 të punësuar, prej tyre 4 janë persona me aftësi të kufizuara, d.m.th. ministria në fjalë është afër zbatimit të Ligjit ndërsa pjesa e Ministrisë së Infrastrukturës raporton të ketë 248 zyrtarë civilë, ndërsa sa i përket zyrtarëve me aftësi të kufizuara raportohet se kanë vetëm një 1 zyrtar me aftësi të kufizuara prandaj konsiderohet se nuk është plotësuar kuota e punësimit sipas ligjit në fjalë.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka raportuar se aktualisht nuk e ka asnjë person të punësuar me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht nuk e kanë plotësuar fare kuotën sa i përket Ligjit me Nr. 03/L-019.

Ministra e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike (ish-MAP), duke i përfshirë edhe agjencitë ARC (Agjencia e Regjistrimit Civil), ASH (Agjencia e Shoqërisë së Informacionit) dhe IKAP (Instituti i Kosovës për Administratë Publike), kanë gjithsej 942 nëpunës civilë. Ndërsa, numri i të punësuarve me aftësi të kufizuara është gjithsej 7 nëpunës civilë (4 në MPB dhe 3 në ish-MAP) që tregon se kuota e punësimit sipas ligjit pjesërisht është e respektuar ose afërsisht 35 % .

Ministria e Ekonomisë ka raportuar se nuk e ka të përmbushur kuotën sa i përket Ligjit me Nr. 03/L-019 dhe nuk kanë raportuar detaje të tjera.

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka raportuar se nuk e ka të përmbushur kuotën sa i përket Ligjit me Nr. 03/L-019 për Aftësim dhe Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk ka dërguar detale të tjera.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka raportuar se ka 285 shërbyes civilë ndërsa të punësuar janë 2 persona me aftësi të kufizuara dhe me këtë rast e ka të plotësuar vetëm pjesërisht kuotën e bazuar në Ligjin me Nr. 03/L-019, ose nga së paku 5 sa duhet të ishte ka vetëm 2 të punësuar.

Vlen të theksohet se institucionet të cilat nuk i kanë kryer obligimet krahas ligjit në fuqi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara janë shprehur se përgjatë vitit në vazhdim do të ndërmarrin veprime konkrete që të plotësojnë kuotën sipas ligjit dhe po ashtu edhe obligimin që rrjedh nga vendimi në fuqi i Kryeministrit të Kosovës. Në këtë drejtim, organizatat të cilat përfaqësojnë kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar kanë ofruar mbështetjen e tyre institucioneve në procesin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Pjesë e aktiviteteve dhe raportimit kushtuar vitit të aftësisë së kufizuar në Kosovë ka eqnë edhe ndërmarrja e në varg aktiviteteve, nga të cilat shumica është zbatuar.

Vendim i Kryeministrit i cili bazuar në ligjin për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar obligon institucionet që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e PAK është zbatuar dhe Kryeministri ka lëshuar vendimin i cili obligon institucionet që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e PAK.

Institucionet kanë pasur për detyrë të identifikojnë numrin e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) të cilët janë të obliguar të punësojnë dhe duke bërë sistematizimin e vendeve të punës dhe re-organizimin e brendshëm caktojnë pozitat për të cilat shpallin konkurset dhe më tutje duke respektuar procedurat e vlerësimit punësojnë PAK.

Nga zyra e kryeministrit është kërkuar që ministritë të raportojnë lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuar në institucionet e tyre të cilët janë të punësuar si dhe numrin që duhet të punësohet për të plotësuar kuotën e kërkuar me Ligj dhe kjo poashtu është kryer.

Por përveç identifikimit një pjesë e ministrive nuk kanë bërë diçka më shumë për plotësimin e kuotave të synuara.

Sa i përket aktivitetit të ndërmarrjes së veprime për të siguruar qasje në institucione për të punësuarit me aftësi të kufizuara disa ministri kanë pasur masa konkrete, pasi doisa objekte vetvetiu plotësojnë kushtet, por një pjesë e e madhe e institucioneve nuk kanë qasjen e duhur.

Lidhur me obligimin e Inspektoratit të punës për inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK, MFPT ka raportuar se lidhur me obligimin e Inspektoratit të Punës, për inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK, fatkeqësisht inspektorati nuk mban të dhëna të veçanta specifike. MFPT ka informuar inspektoratin e punës lidhur me inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK.

Ndërkohe është lëshuar një qarkore/informatë publike për obligimin e zbatimit të këtij ligji dhe është hapur UNIREF në të cilin mund të depozitohen dënimet nga bizneset që nuk e zbatojnë kuotën dhe ky fond do të shkojë për personat me aftësi të kufizuara.

## Mundësia e regjistrimit dhe funksionimit të Ndërmarrjes Sociale

Qeveria e Republikës së Kosovës saktësisht Ministria e Financave Punës dhe Transfereve kanë aprovuar rregulloret që deprimojnë nga Ligji për ndërmarrësi Sociale (06/L022) për aplikim për njohjen e statuti si ndërmarrjes sociale.

MFPT ka krijuar një divizion përkatës që do të merret ekskluzivisht me ndërmarrje sociale, pastaj është themeluar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për njohjen e statuti për ndërmarrësi sociale.

Si rrjedhojë, ky komisioni apo divizion, ka mbajtur në të gjitha qytetet takime informuese dhe ne si Shoqata e të Verbërve të Kosovës kemi qenë pjesë e sesionit informues në Prishtinë me 24 Janar 2024, ku kemi marrë njohurit e duhura për të aplikuar për krijimin e një ndërmarrje sociale e cila do t'ju shërbejë të gjithë personave të verbër por edhe personave tjerë me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i krijimit të kësaj ndërmarrje, mund të hapë mundësi të reja për shoqatën, nëse do të kemi mundësi ta marrim këtë statut. Para disa vitesh Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka qenë përfituese e një donacioni nga Shoqata Feniks, e cila në partneritet me SHVK si liderë e projektit kanë përfituar projektin nga Agjensioni Ceke për Zhvillim në uadër të të cilit është dhuruar donacion makineri dhe pajisje adekuate për përpunimin e kutive dekorative prej letre.

Andaj, këto pajisje pas një funksionimi të kohë pas kohëshme, ka një vit që janë mbetur nën menaxhimin e SHVK, pa mundur të aktivizohen dhe duke krijuar kosto pasi SHVK ka edhe ngarkesë pasi që qiraja e tyre është barrë për SHVK-në.

Tani me krijimin e mundësive për të pasur statutin e ndërmarrjes sociale, ne fillimisht kemi bisedua me një kompani D&D për të na mundësuar fillimisht hartimin e planit të biznesit, i cili parasheh fillimisht një analizë të tregut në Kosovë, pastaj marketingun dhe mundësitë e përfitimit, etj.

SHVK në këtë fazë fillimisht ka ftuar anëtarët e bordit për të vendosur rreth themelimit, janë përcaktuar anëtarët e bordit dhe themeluesit. Anëtarët e Bordit janë: Daut Tishuki, Felona Bajrami dhe Zahide Arifi ndërsa si drejtor ekzekutiv Bekim Krasniqi, pasi që i njëjti ka qenë edhe në shoqatën Feniks si drejtues i saj dhe ka njohuri rreth menaxhimit të kësaj punëtorie.

Ndërsa pas kësaj kemi angazhuar një ekspert për vendosjen e emrit të ndërmarrjes sociale dhe bashkë me stafin e SHVK dhe bordin e themeluar kemi marrë pëlqimin që ndërmarrja sociale të quhet "KUTIBOKS".

Në ditët në vijim do të fillojmë me regjistrimin e ndërmarrjes, duhet hartuar edhe statuti dhe pastaj të fillojmë me hapat tjerë deri në finalizim.

Gjithashtu, ne kemi një ofertë për shprehje të interesit nga shtypshkronja AGIMI DE, që ka shpreh interes që të lidhim një marrëveshje bashkëpunimi në mënyrë që këto pajisje t'i funksionojmë por marrëveshjen e bashkëpunimit mendojmë të lidhim pas regjistrimit si shoqatë ndërmarrësie.

## Nga aktivitetet e QBMK Xheladin Deda, edukimi i personave të verbër

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta shkolla për të verbër ka zhvilluar aktivitetet e gjysme vjetorit të dytë të vitit shkollor. Aktivitetet e zakonshme të ofrimit të shërbimeve në fushën e edukimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe realizimin e të plan programit. Shkolla mban dhe zhvillon partneritetet e veta, nxit pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet jashtë shkollor dhe ofron ekspertizën për të gjitha palët tjera që kanë nevojë për ekspertizë në fushën e edukimit special, duke përfshirë partneritetin e përhershëm me Shoqatën e të verbërve në Pejë. Gjatë kësaj periudhe janë priturore nxënës na katër shkolla fillore të Pejës që janë njohur me shkollën dhe mundësitë e shkrimit braille për personat e verbër, mundësia e praktikës profesionale për asistentët e ardhëm për fëmijë me nevoja të veçanta dhe takime me palë e bashkëpunëtorë.

### **Takimet e grupit punues në kuadër të MASHTI për lëtyrën shkollore.**

Anëtari i QB në këtë grup ka marrë pjesë në disa punëtori duke paraqitur komente dhe sugjerime për kriteret dhe listën e librave.

**Angazhimi me ekspertizë për AKK.** Një anëtarë ka qenë në ekipin vlerësues në kuadër të Autoritetit kombëtar të akreditimeve për vlerësimin e ofertuesit privat të shërbimeve të kualifikimit të asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta në Kosovë.

**Takim dhe bashkëpunim me OJQ Amelie nga Prishtina.** Në takim është diskutuar për përgatitjen e librave audio për nxënësit e verbër nga puna e tyre vullnetare dhe me projekte. Atyre iu është prezantuar legjislacioni për të drejtën e autorit, lista e librave audio që ne kemi dhe lista e librave për të cilat kemi nevojë, tri tekste shkollore, tri lëtyra shkollore.

### **Praktikë profesionale për 4 asistentë nga komuna e Gjakovës**

Katër vijuese të kursit për kualifikimet e nivelit 5 persona për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore nga Gjakova kanë filluar praktikën profesionale në kohëzgjatje 150 orë mësimore.

### **Vizitat nga nxënësit e shkollave fillore të komunë së Pejës**

Vizitë nga nxënës të shkollës Asdreni, Lidhja e Prizrenit, Tetë marsi, Vaso Pashë Shkodrani për t'u njohur me shkollën, mësimin dhe alfabetin braille. Ata kanë vizituar klasat dhe kanë parë shkrimin dhe leximin e brajtit.

### **Komunikimi me publikun**

Në informim të vazhdueshëm të publikut janë mbajtur faqet e rrjetave sociale me postime, komente, shpallje të informatave dhe konkurseve për vendet e reja të punës. Pos postime në rrjetet sociale ka pasur edhe një artikull për aktivitetet dy mujore të QBMK Xheladin Deda në revistën "Syri ynë" dhe aktivitete tjera promovuese gjithë me një publik më të gjerë të synuar.

## Drejtësia, për kë dhe kujt i duhet?

Artikull nga Sinan Tafaj, doktor i shkencave juridike, person i verbër anëtar i bordit ekzekutiv të EBU-së

Drejtësia është në duart e hajdutëve, kriminelëve, të cilëve ju mungon ndershmëria, dhe për pasojë dhe e drejta morale për të gjykuar konfliktet e këtyre aktorëve me shtetin apo dhe në mes tyre. Politikanët, nga njëra anë kanë vendosur si objektiv politikë të rëndësishme reformën në drejtësi dhe rritjen e besimit publik te drejtësia. Nga ana tjetër, sapo të ndjejnë se po ju afrohet rreziku, ata fillojnë i gjuajnë drejtësisë

### Perceptimi Shoqëror

Aq shpesh e përmendim, aq shumë i drejtohem i sa shumë kush mendon se pa drejtësinë nuk ka jetë ose të paktën ka një jetë, por pa cilësi dhe të pasigurt. Qytetarët kur i referohen drejtësisë, e mendojnë atë si çështje barazie, ndershmërie apo korrektese. Në fakt kështu është, nëse e vlerësojmë atë mbi bazën e rregullave morale të trashëguara e të gjithpranuara. Rëndomtë, njerëzit shfryjnë kundër pabarazisë, thyerjeve, dhe shkeljeve të vazhdueshme të atyre normave të mira dhe të drejta që trashëguam nga brezat, duke mos qenë dakord me realitetin e krijuar, kohën, qeverisjen, brezin e ri e të tjera.

### Drejtësia sipas Ligjit

Kur flasim për sistemin e drejtësisë nënkuptojmë një seri organesh, strukturash, rrethanash sociale, ekonomike dhe më gjerë. Megjithatë, drejtësia e ligjit, rezultatin final e ka nga vendimet e Gjykatës, pra nga gjyqtarët. Nuk kam dashur të shkruaj për këtë çështje, por si pjesë e sistemit të drejtësisë, përfaqësues ligjor i qytetarëve, kohët e fundit po ndihem keq nga mënyra se si organet e drejtësisë, veçanërisht gjyqtarët dhe prokurorët po anatemojnë dhe denigrohen. Po dëgjoja në një televizion, vlerësimin e avokatëve për kushtet e vështira, në të cilat punojnë gjyqtarët, mungesën e sallave të gjyqimit, zyrat e vogla e mungesa të tjera bazike, për të cilat vlerësimi i tyre është i saktë. U preka shumë nga cinizmi i moderatorit të emisionit, i cili duke komentuar qëndrimin e avokatëve në panel, u shpreh se: “Imagjini këta të pasur që rrinë në këto zyra kaq të vogla”? Pra perceptimi i moderatorit, analistit, politikanit, biznesmenit, kriminelit dhe qytetarit të thjeshtë është se të jesh gjyqtar, apo prokuror je i pasur. Pra megjithëse të gjithë janë shumë qartë se këta janë rrogëtarë të shtetit, me paga të përcaktuara, që kurrsesi nuk të bëjnë të pasur, ato janë absolutisht të supozuar si të pasur. Pra drejtësia jepet nga funksionarë të shtetit, mbartës të pasurisë të paligjshme. Pra sipas kësaj, drejtësia është në duart e hajdutëve, kriminelëve, të cilëve ju mungon ndershmëria, dhe për pasojë dhe e drejta morale për të gjykuar konfliktet e këtyre aktorëve me shtetin apo dhe në mes tyre. Politikanët, nga njëra anë kanë vendosur si objektiv politikë të rëndësishme reformën në drejtësi dhe rritjen e besimit publik te drejtësia. Nga ana tjetër, sapo të ndjejnë se po ju afrohet rreziku, ata fillojnë i gjuajnë drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve me gjithë fuqinë që kanë. Kurrë nuk kam dëgjuar një vlerësim pozitiv për drejtësinë, për gjyqtarët apo prokurorët, përveçse ndonjë rast kur ata kanë qenë përfutur të shërbimeve të tyre. Madje, për të justifikuar reformën në drejtësi, politikanët kanë përdorur si justifikim shbërjen e sistemit dhe kanë sulmuar sistemin ekzistues në mënyrën më denigruese e cinike të

mundshme. Aq popullore u bënë sulmet e politikës ndaj Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sa edhe fëmijët e tyre nëpër shkolla kishin turp të tregonin se janë të bijtë e këtyre gjyqtarëve, apo prokurorëve. Ata talleshin nga moshatarët e tyre duke thirrur: “ Ej ti i biri i KCK ....apo i atij me çekiç.... e apo i atij me togë së zezë”. Mbrojtja më e mirë e politikanëve – kriminelëve po kriminelëve-politikanë, kriminelëve-biznesmenë apo biznesmenëve-kriminelë është sulmi nominal mbi çdo gjyqtar apo prokuror, që u ka rënë shorti për të hetuar apo gjykuar ata vetë apo interesat e tyre, qofshin edhe dytësore.

### **Çfarë të bëjnë Gjyqtarët e Prokurorët?**

Jo vetëm qëllimi, por edhe pasojat e një sulmi nominal mbi gjyqtarët dhe prokurorët janë kriminale. Ulja e nivelit të besimit të publikut te drejtësia është premisë për anarshi dhe cenimin e bazave të demokracisë. Shërben si justifikim për tranzicionin e zgjatur dhe për pasojë mbajtjen në pushtet të arkitektëve të këtij tranzicioni. Qëllimi i vetëm është paralizimi i shoqërisë, ndërprerja e qarkullimit të vlerave më të mira njerëzore të trashëguara e të riprodhuara, krijimi i një ligatine me ujë të ndenjtur, ku të peshkuarit janë vetë qytetarët e përjashtuar nga mundësia për të ndërtuar demokraci. Politika, krimi dhe biznesi e dinë fare mirë se gjyqtarët edhe prokurorët janë të përjashtuar nga mbrojtja e tyre publike. Ata janë pa zë, por duhet të jenë të përjashtuar nga gjykimi si aktore politike, ekonomike dhe te mbrojtur nga ligji dhe opinioni publik në ushtrimin e funksionit të tyre të gjykimit. Të vetmen mbrojtje që ata kanë është vendimmarrja e tyre në zbatim të ligjit. Sistemi i drejtësisë, vlerësimin e këtyre vendimmarrjeve nëpërmjet ankimeve e ka përcaktuar saktësisht në hierarkinë e organeve gjyqësore, si Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë, ankimi në Gjykatën Kushtetuese apo i atij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Starsbourg. Gjyqtari nuk ka mundësi të kënaqë të gjitha palët në proces, pasi e vërteta është një dhe ky është misioni i tij. Të pandershmit, hileqarët dhe kriminelët abuzojnë me naivitetin e publikut duke vlerësuar e komentuar vendimet e gjyqtarëve apo të prokurorëve në interes të tyre dhe duke i bërë ato pjesë të diskutimit publik. Në këtë mënyrë Gjyqtarët dhe Prokurorët bëhen pjesë e ligatinës së krijuar nga politikanët-kriminelë dhe kriminelët-politikanë duke i shndërruar këta të fundit në viktima të tyre dhe duke i përdorur si instrumenta, jo për të dhënë drejtësi, po për të përcaktuar ekuilibrin e forcave në luftën e tyre politike dhe ekonomike. Në vendet demokratike gjyqtarët janë njerëz pa zë, por çekiçi i tyre e ngul gozhdën pikërisht aty ku garantohet ekuilibri shoqëror. Gjyqtarët gëzojnë një status të veçantë, të mbrojtur në opinionin publik. Po të shkosh në gjykatat tona altoparlantët në korridore ofshëtijnë me emrat e palëve, numrin e sallës, po veçanërisht emrin e gjyqtarit, e cila në vlerësimin tim nuk është aspak normale. Gjyqtari nuk ka emër, gjyqtari është institucioni, është gjykata, është drejtësia. Parlamenti dhe Qeveria mburren se kanë rritur rrogat e gjyqtarëve, por në fakt atyre nuk jua kanë garantuar kushtet më minimale. Në asnjë vend demokratik, nuk i gjen gjyqtarët si banorë në mes të çdolloj shtrese. Atyre iu garantohet jo vetëm banesa, por edhe ambienti i banimit, siguria nga kontaktet me keqdashësit apo nivelet e tjera të ulta e sidomos siguria nga cenimet a presionet e krimit dhe politikave kriminale.

### **Konkluzion**

Përfundimisht, ne Shqiptarët nuk do mund të ndërtojmë demokracinë, pa garantuar më parë shtetin ligjor. Ne Shqiptarët nuk do mund të kemi shtet ligjor, pa garantuar funksionimin real e efektiv të sistemit gjyqësor. Ne Shqiptarët nuk do mund të kemi një sistem real e efektiv gjyqësor pa garantuar

integritetin dhe mbrojtjen e vërtetë dhe dinjitetin e personalitetin e çdo Gjyqtari dhe Prokurori. Ne Shqiptarët nuk do mund të mbrojmë integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve pa pastrimin e politikës nga krimi. Ne Shqiptarët nuk do mund të pastrojmë politikën nga krimi pa garantuar integritetin tonë, dinjitetin dhe personalitetin e secilit nga ne. Ne Shqiptarët nuk do mund të mbrojmë veten tonë, pa u vendosur në themel të çdo veprimtarie institucionale liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Ne Shqiptarët nuk do mund t'i mbrojmë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut pa garantuar votën e lirë për veten tonë.

## Qasja për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, qasja fizike në objekte

Qasja për personat me aftësi të kufizuara ka mjaft rëndësi për krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta. Bëhet fjalë për qasjen fizike, qasjen në materiale, informata dhe krijimin e mundësive të përfshirjes dhe konkurrencës për personat me aftësi të kufizuara.

Shoqatat e aftësisë së kufizuar bashkë me Qeverinë e Kosovës në kuadër të planifikimit të aktiviteteve në dy vjetet e kaluara për zbutjen e kësaj çështjeje kanë planifikuar gjashtë aktivitete me të cilat është punuar dhe në raportimet e përmbledhura nga vitit 2023, plotësimi ka qenë gjysmak.

Fillimisht, bazuar në raportet e Ministria e Infrastrukturës Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin për ndryshimi dhe plotësimin e vendimit të vet mëparshëm duke lënë në fuqi Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara deri në nxjerrjen e udhëzimit të ri administrativ që rregullon këtë çështje”. Po ashtu, Ministria ka raportuar se është hartuar qarkorja për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ dhe gjatë muajit gusht 2022, pas aprovimit nga Zyra e Ministrit është dërguar në institucionet komunale.

Sa i përket problemit të parë të ngritur lidhur me qasjen fizike në objektet e qendrave për patentë shoferë në raportin e dorëzuar nga Ministria e Infrastrukturës thuhet se nuk është plotësuar ende, por janë në kontakt me njësitë regjionale si Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren për realizimin e qasjes fizike në objektet përkatëse për personat me aftësi të kufizuar, por disa nga problemet janë se një pjese e objekteve janë të marra me qira dhe janë në diskutim me qiradhënësit për të realizuar qasjen fizike për këtë kategori, por këto investime pronarët nuk kanë i kanë pasur në planin e investimeve.

Edhe kërkesa tjetër që në auto shkolla, të ketë edhe një automjet të qasshëm (me pajisje ndihmëse për vozitje) për personat me aftësi të kufizuara dhe në UA për licencimin për auto-shkolla të përfshihet edhe qasja për personat me aftësi të kufizuara, poashtu nuk është plotësuar. Ligji aktual thotë se aftësimi i kandidatëve me aftësi të kufizuara mund të kryhet me automjet të adoptuar, i cili mund të jetë në pronësi të kandidatit, të shoqatës së personave me aftësi të kufizuara apo i huazuar. Vështirësia që është hasur në këtë çështje është se legjislacioni aktual nuk lejon hapësirë që të detyrohen auto-shkollat të posedojnë automjet për personat me aftësi të kufizuara. Sipas Ministrisë së Infrastrukturës procedurat për ndryshimin e ligjit për patentë shofer kanë filluar, dhe aty mendohet të përfshihet ky ndryshim që mbulon këtë fushë.

Sa i përket kërkesës që aeroporti i Prishtinës të furnizohet me karroca standarde që përdoren edhe brenda aeroplanit për personat me aftësi të kufizuara, ANP Adem Jashari ka informuar se nga viti 2013 ofron një shërbim të detajuar të pasagjerëve me lëvizshmëri të reduktuar në përputhje me Rregulloren e BE-së dhe këto shërbime ofrohen me miratimin dhe koordinimin e Linjave Ajrore. Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara të cilët janë shfrytëzues të karrocave raportojnë se mungojnë karrocate adekuate për lëvizje brenda aeroplanëve, që ka qenë kërkesa e tyre fillestare e cila është specifikuar në Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2022. Ndërkaq ANP raporton se Këndi Informues të aeroportit ka vendosur tabletët për komunikim me interpretuesin e gjuhës së shenjave (në mungesë të një aplikacioni vendor, ne në tabletë janë instaluar aplikacionet e gjuhës së shenjave ndërkombëtare).



Mjaft me rëndësi në jetën e përditshme ka qenë kërkesa për qasjen në autobusët e trafikut ndër-urban, pjerrinat dhe informimi në audio për Persona me Aftësi të Kufizuara, që është implementuar pjesërisht. Ministria e Infrastrukturës ka filluar punën ndryshimin e ligjit për transportit rrugor, që do adresojë këtë çështje. Ka filluar puna dhe janë duke u analizuar direktivat dhe rregulloret e BE-së, të cilat do të përfshihen në draft udhëzimin administrativ për krijimin e kushteve teknike të mjetet e transportit publik dhe të drejtave të udhëtarëve në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë personave me aftësi të kufizuara dhe në kuadër të procesit të licencimit do të përcaktohet edhe kriteret teknike të autobusëve me kushte dhe infrastrukturë për të mundësuar marrjen, zbritjen dhe informimin e personave me nevoja të veçanta. Por më pas kanë munguar aktivitetet në finalizimin e punës nga grupi punues. Sa i përket të njëjtës kërkesë për taksitë ku synohet që operatorët e taksive të posedojnë së paku një veturë të qasshme me rampë/pjerrinë, Ministria e Infrastrukturës ka raportuar se vetë komunat përcaktojnë kriteret për dhënien dhe revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së taksive, ndërsa komunat nuk kanë raportuar nëse kanë mundësi të zbatojnë apo jo.

Dhe kërkesa e fundit në këtë listë ka qenë që në 5 komuna të Kosovës do të identifikohen pengesat/barrierat dhe vlerësohet qasshmëria e një rrugë apo sheshe, duke llogaritur dizajnet dhe kostot. Për këtë Ministria e Administrimit të Pushtetit me përfaqësues nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve dhe HandiKOS, kanë takuar kryetarë të komunave Peja, Gjilani, Gjakova, Mamusha dhe Mitrovica e Jugut, dhe kanë krijuar një pasqyrë të gjendjes. Në Pejë janë identifikuar 22 objekte të cilat kanë qasje fizike për PAK; 11 objekte që nuk kanë fare qasje për PAK; 4 shkolla që nuk kanë qasje. Në objektet shëndetësore ka qasje fizike, ndërsa sa i përket objektit kulturor, mungon qasje në Galeri.

Në Gjakovë janë vizituar 46 institucione arsimore asnjëri nuk i plotëson tërësisht standardet, hyrjen fizike në objekt nuk e ka vetëm njëra shkollë, por ashensor dhe qasje në katet e mësipërme dhe tualetet e përshtatura për PAK nuk e ka asnjë. Ndërsa, nga 25 objektet e QMF të gjitha i plotësojnë kushtet sipas standardeve që posedojnë për hyrjen, ndërsa vetëm një ka ashensor. Nga 52 objektet e institucioneve publike e private që janë identifikuar, vetëm 7 nga to i plotësojnë kushtet sipas standardeve që posedojnë hyrjen me qasje për PAK, qasjen në katet e larta të objekteve dhe tualetet për PAK. Trotuaret në zonën urbane në shumicën e vendkalimeve nuk kanë pjerrina adekuate dhe asnjë trotuar nuk ka shirita për orientim për personat e verbër. Në shumicën e vend parkimeve publike, mungojnë shenjat për vendet e rezervuara për PAK, kurse nga udhëkryqet me semafor vetëm njëri është i pajisur me sinjale akustike për personat e verbër.

Në komunën e Gjilanit nga 32 shkollat që janë vizituar, asnjë nga to nuk i plotëson kriteret sipas standardeve, një shkollë nuk e ka as qasjen në hyrje, por në të tjerat nuk ka ashensorë që çdo nxënës të ketë mundësi për qasje në katet e epërme të objekteve, kurse 7 nga shkollat kanë tualetet për PAK.

Ndërsa, nga 42 objektet e institucioneve publike e private që janë identifikuar, vetëm 4 nga to i plotësojnë kushtet sipas standardeve për qasjen në hyrje për PAK. Një objekt nuk ka qasje as në hyrje. 18 objekte janë objekte pa ashensor për PAK, derisa 9 prej tyre janë 1 katëshe, 15 kanë ashensor. Nga këto 42 objekte, dhjetë prej tyre i plotësojnë kushtet me tualete të përshtatshme për PAK.

Në Mitrovicën e Jugut përveç Shkollës Model "Ismail Qemali", asnjë shkollë tjetër nuk i plotëson standardet duke përfshirë 28 shkolla fillore, 4 shkolla të mesme, si dhe 1 kopshte publike, si dhe shkolla e muzikës, "Tefta Tashko". Komuna po renovon objektin e saj dhe është planifikuar edhe ashensori, me qasjen e PAK, gjithashtu edhe me qasje sipas standardeve në pjerrina, shërbime dhe tualete.

E në Komunën e Mamushës asnjëri nga dy shkollat nuk i plotëson kriteret sipas standardeve, ato e kanë qasjen për PAK në hyrje të shkollave, por jo edhe qasjen në katet e epërme të objekteve, dhe nuk kanë tualetet për PAK. Objekti i QKMF i plotëson kushtet sipas standardeve për qasjen e PAK, ndërsa nga 7 objektet e institucioneve publike e private, të gjitha i plotësojnë kushtet sipas standardeve.

## Lajme sportive- aktivitetet sportive për personat e verbër

### **Garat kualifikuese të shahut**

Federata e sporteve për të verbër më datën 13 janar ka mbajtur garat e shahut në Shëngjin të Shqipërisë, ku pjesëmarrës ishin shahistët nga të gjitha klubet e federatës së sporteve për të verbër, diku rreth 23 shahistë. Ky turnir ishte turnir kualifikues, ku pjesëmarrësit kualifikohen për finalen e kampionatit të shahut për të verbër për vitin 2024. Në këtë turnir 8 shahistë të verbër janë kualifikuar dhe do t'i bashkohen kampionit dhe nën kampionit në finale në turnirin individual të shahut për të verbër. Shahistët të cilët janë kualifikuar për finale janë: Daut Tishuki, Azem Avdija, Asllan Canolli, Shaip Kastrati, Daut Hoxha, Xhafer Berisha, Milazim Halilja dhe Bekim Krasniqi.

Ky turnir u mbajt në sistemin zviceran në 7 xhiro dhe me refer ndërkombëtar nga FIDA.

### **Turnir individual në shah për gratë e verbra**

Në kampionatin e mbajtur në Shëngjin gjatë muajit janar për herë të parë u mbajt turniri individual i shahisteve të verbra të Kosovës ku pjesëmarrëse ishin 8 shahiste dhe vendin e parë e zuri Zahide Arifi, e cila do të merr pjesë në garën finale të shahut.

### **Referi kosovar referoi një ndeshje ndërkombëtare në Malmo Open 2024**

Për herë të parë Anton Prekaj referoi në disiplinën e golballit në turnirin Malmo Open 2024 gjatë muajit shkurt. Në këtë kampionat pjesëmarrës ishin stafi i Federatës së sporteve për të verbër, që zhvilloi takime të ndryshme me akterë nga fusha e sportit. Kosova ka disa vjet që ka marrë pjesë në garat e mbajtur në Malmo ku është pritur mirë dhe ka pasur paraqitje të pranueshme.

### **Takime të federatës sportive të të verbërve të Kosovës me Suedinë**

Me datën 12.02.2024 u mbajt takimi Takimi i kryetarit të FSVK-së me kryetarin dhe nënkryetarin e Federatës së Goalballit të Suedisë, z. Peter Svensson dhe z. Fatmir Sheremeti me të cilët u diskutua mundësitë për të vazhduar përkrahjen për goalballin e Kosovës. Gjatë takimit z. Sheremeti shprehi gadishmërinë që me disa referë e trajnerë ndërkombëtarë dhe të licensuar të IBSA-s të mbajë trajnim disa ditore në muajin Shtator të këtij viti edhe në Kosovë.

### **Memorandumet e bashkëpunimit për aktivitetet sportive për personat me aftësi të kufizuara.**

Zëvendësministrja e MKRS, Daulina Osmani në muajin shkurt ka nënshkruar memorandumet e bashkëpunimit me presidenten e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Njomza Emini, presidenten e Olimpiadës Speciale të Kosovës, Igballe Asllani-Potera dhe kryetarin e Federatës së Sporteve për të Verbër të Kosovës, Rinor Ymeri.

Me Komitetin Paralimpik të Kosovës u nënshkruan dy memorandume, i pari për zhvillimin e aktiviteteve vjetore të tij në kuadër të sportit për personat me aftësi të kufizuara fizike, ndërsa i dyti për fuqizimin e

federatave parasportive të KPK-së, përkatësisht të Federatës së Para Boccias të Kosovës, Federatës së Basketbollit me Karroca të Kosovës dhe Federatës së Paravolejbollit të Kosovës.

Krahas mbështetjes së vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara fizike në sport, kësaj radhe për herë të parë është mbështetur me memorandum vjetor edhe Olimpiada Speciale e Kosovës, e cila njihet me Ligj të Sportit dhe angazhohet për zhvillimin e aktiviteteve sportive tek personat me aftësi të kufizuara intelektuale.

Memorandumet janë nënshkruar me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të këtyre organizatave në kuadër të planit vjetor të tyre përgjatë vitit 2024, duke përfshirë këtu aktivitetet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Totali i vlerës financiare të mbështetur është 400 mijë euro, që është shuma më e lartë e dhënë ndonjëherë në formë të memorandumëve vjetore për organizatat sportive të personave me aftësi të kufizuara.

### **Gati për lojërat parasportive në Vushtrri**

Me datën 02 mars 2024 do të mbahen lojërat parasportive në Vushtrri, ku pjesëmarrës do të jenë të gjitha federatat parasportive dhe do të zhvillohen gara në golball, volejboll ulur, shigjetari, tërheqje me litar, basketboll me karroca, boccia, dhe disiplina të tjera rekreative. Këto gara mbahen me mbështetjen financiare të UNMIK. Ekipet janë bërë gati për garim dhe paraqitje sa më të mirë.

## Sporti për të verbër ndër vite, shoqata sportive “Shkolla”

### **Në marsin e vitit 2023 në QBMK “Xheladin Deda” në Pejë u formua Shoqata Sportive “SHKOLLA”**

Me qëllim të zhvillimit, avancimi dhe masovizimit të sporteve për persona të verbër, me qëllim të krijimit të kushteve për plotësimin e nevojave të aktiviteteve në lëmin e para sporteve dhe sporteve paralimike më 3 mars 2023 nga mësimdhënës dhe nxënës të QBMK “Xheladin Deda” në Pejë u themelua Shoqata Sportive “SHKOLLA”.

Formimi i kësaj shoqate sportive ishte një zyrtarizim institucional i organizimit të klubit të shkollës për krijimin e kushteve që si pjesë e Federatës së Sporteve për të Verbër të garoj si klub i certifikuar në garat e rregullta vendore dhe ato ndërkombëtare.

Shoqata Sportive “Shkolla” po bën një vit nga certifikimi, por aktivitetet sportive për personat e verbër kanë zanafillë mbi gjysmë shekulli. Fillesat e aktiviteteve sportive tek të verbëritë në Kosovë lidhen me organizmin e tyre në shoqata. Të verbërit në Pejë filluan të organizohen qysh në vitin 1946. Në atë kohë kjo veprimtari e tyre ishte e lidhur me entin për kujdesin social të qytetit. Në këtë formë punuan derisa u formua shoqata e tyre.

Gjatë viteve '70 –ta në fushën e sportit dhe shahut u arritën suksese te konsiderueshme si për nga pjesëmarrja më masive ashtu edhe me rezultatet e arritura jo vetëm në garat krahinore por edhe në ato republikane dhe federative ( ish Jugosllavi).

Hapja e Shkollës Speciale për të verbër në Pejë në vitin 1982 shënon një kthesë të madhe në arsimin e të verbërve në Kosovë, e me këtë edhe të aktiviteteve sportive. Që në vitin e parë shkollor 1982/1983 në kuadër të aktiviteteve të lira në shkollë filloj të funksionoj sektori i sportit. Aktiviteteve sportive të nxënësve ju dha rëndësi e veçantë sepse ndikonte në ndërtimin e personalitetit dhe fitimin e shkathtësive për jetën.

Shkolla kishte bashkëpunim të ngushtë me Lidhjen e të verbërve të qytetit të Pejës ku stërvitjet sportive u kryenin bashkërisht. Në Lidhjen e të Verbërve të Pejës ekzistonte Klubi i shahut “Luji Braj”, që zhvillonte gara në Ligën e dytë të Kosovës në shah, ngjyrat e të cilit aktivisht i kanë mbrojtur edhe nxënësit e kësaj shkolle në cilësinë e pionierëve dhe juniorëve. Ndër më të dalluarit nga nxënësit ishin Frashër Dërmaku, Jashar Kuliqi, etj.

Nxënësit e kësaj shkolle kanë marrë pjesë rregullisht çdo vit në garat krahinore dhe federative ( Jugosllave) të shahut, të gollballit dhe atletikës dhe kanë treguar rezultate solide me çka janë nderuar me mirënjohje dhe medalje për sukseset e arritura.

### **1999-Pas lufta**

Pas luftës së fundit në Kosovë kushtet dhe rrethanat ndryshuan dukshëm. Fillimi i reformave në arsim sollti nocione dhe koncepte të reja në trajtimin e arsimit special. Kjo bëri që në shoqërinë tonë filloi një shndërrim rrënjësor qëndrimesh e paradigmath konceptuale, të cilat u fokusuan në gjithëpërfshirje, në

të drejtat, në mundësitë e barabarta dhe në pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Edukimi fizik dhe sporti shihej si një sektor potencial më aktiv dhe më mbështetës në procesin gjithëpërfshirjes në shkolla.

Prandaj këtij sektori si hallkë e rëndësishme për fitimin e shkathtësive dhe pavarësimin e nxënësve të verbër, në këtë shkollë i kushtohet kujdes dhe përkushtim i veçantë. Aktivitetet sportive tashme ishin të organizuara dhe të strukturuar me pjesëmarrjen e rregull në të gjitha organizimet sportive në vend por edhe në shumë turnire ndërkombëtare. Për tre vjet radhazi ekipi i shkollës mori pjesë në Turnirin Ndërkombëtar të torballit për të rinj deri në 18 vjet të organizuar në Zollikofen të Zvicrës (2002, 2003 dhe 2004). Ekipi i shkollës çdo here u rangua në pjesën e epërme të tabelës. Pastaj në turnire të golbollit në Suedi, Belgjikë, Slloveni, Austri etj.

Në vitin 2006 me iniciativën e sportistëve të verbër u themelua Federata e sporteve për të verbër e Kosovës, kryetar i së cilës ishte Daut Tishuku. Po në këtë vit FSVK në bashkëpunim me QB "Xheladin Deda" në Pejë organizuan një seminar treditör për avancimin e golbollit me ligjërimin nga ekspert të njohur ndërkombëtar nga IBSA (Asociacioni Ndërkombëtar i Sporteve për të Verbër). Pas tri ditë pune efektive u licencuan 15 refer dhe u profesionalizuan trajnerët dhe kapitenet e ekipeve. Seminari ishte një hap i madh që krijonte kushtet bazë për fillimin e ligës së Golbollit të Kosovës. Kjo do të ndikonte që sa më shumë golbolli i Kosovës të afrohet drejt Federatës Evropiane të sporteve për të verbër. Këtu u vunë bazat e sportit elitari duke u krijuar kushtet për pjesëmarrje në lojëra ndërkombëtare në kushte të barabarta.

Në shkurt të 2007 Federata e sporteve për të verbër organizoi kampionatin e parë individual të shahut për të verbër ku 4 nxënësit e kësaj shkolle morën pjesë në këtë kampionat dhe korren suksese të lakmueshme. Më 22 prill 2007 ekipi i shkollës mori pjesë në garat e sezonit pranveror të Kampionatit të Parë të golbollit të Kosovës 2006/2007.

Që nga viti 2021 QBMK "Xheladin Deda" u bë pjese e projektit "Drejt malit" ku me mësimdhënësit dhe instruktoret e vet organizon kursin e skijimit për nxënësit verbër.

Në kuadër të Shoqatës Sportive "Shkolla" funksionojnë: Klubi i Golbollit, Klubi i Shahut, Klubi e xhudos, Klubi i Futbollit për të verbër dhe Kursi fillestar e skijimit për të verbër.

Aktualisht Shoqata Sportive "Shkolla" në gjirin e vet përfshin shumë nxënës me dëmtime në të parë nga shkollat e rregullta të cilët janë në mbështetjeje nga QBMK "Xheladin Deda" në Pejë si dhe shumë ish nxënës që në Klubin e Shahut, Golbollit dhe Futbollit për të verbër përfaqësojnë denjësisht Shkollën në të gjitha organizimet sportive.

Krahas aktiviteteve sportive, në kuadër të mbështetjes të shkollave të rregullta në fushën e edukimit fizik dhe sportit organizon edhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve profesionale për përgatitjen e trajnerëve sportiv, mësimdhënësve të edukimit fizik dhe profesionistëve të tjerë nga fusha e sportit për të verbër.

Shoqata Sportive “Shkolla” me shumë mësime dhe trajnerë profesionistë ka edhe mision promovimin e kapaciteteve sportive të personave të verbër me qëllim të promovimit të vlerave gjithëpërfshirëse.